

Për informacion dhe vëmendjen Tuaj: Mbi Vullnetarizmin dhe zhvillimin e mëtejshëm të tij në Shqipëri

Të nderuar,

Me anë të kësaj letre, do të donim t'ju bënim me dije mbi iniciativën e ndërmarrë muajt e fundit nga organizata [Përtej Barrierave](#) në bashkëpunim dhe me lehtësimin e [Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile](#) dhe pjesëmarrjen e një grupi organizatash të shoqërisë civile nga bashki të ndryshme të vendit, të interesuara për zhvillimin e vullnetarizmit në Shqipëri dhe të një mjedisi mundësues ligjor e rregullator që do të kontribuonte në këtë drejtim.

Vullnetarët janë një pjesë e rëndësishme e burimeve njerëzore të organizatave të shoqërisë civile, që japin një kontribut të madh dhe shumë të vyer në sfera e sektorë të ndryshëm të shoqërisë si dhe në mbështetjen e zhvillimin e komuniteteve lokale.

Katër vjet pas miratimit të Ligjit 45/2016 “Për Vullnetarizmin”, i cili do duhej të rregullonte fushën dhe veprimtarinë vullnetare në vend, mbetet problematike njohja, kuptimi dhe zbatimi i ligjit, si nga ana e organizatave të shoqërisë civile, po ashtu dhe e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tij. Megjithë qëllimin e mirë për njohjen dhe rregullimin e vullnetarizmit, **kuadri ligjor që rregullon vullnetarizmin** nuk është i plotë dhe mundësues për OSHCtë që punojnë me vullnetarë dhe programe vullnetarizmi, duke u ndeshur me **vështirësi dhe paqartësi** për përfshirjen e vullnetarëve në projektet dhe aktivitetet e tyre dhe duke i ekspozuar ata ndaj riskut të gjobave. OSHCtë ndeshin vështirësi në njohjen, kuptimin e ligjit, akteve nënligjore dhe zbatimin e tyre.

Aktet nën-ligjore të nevojshme për ta bërë ligjin të aplikueshëm e të zbatueshëm që përfshijnë Kodin e Etikës, Rregjistrin e Vullnetarëve dhe Librezën e Vullnetarëve, u aprovuan në vitin 2018 dhe 2019 dhe u bënë të njohura për sektorin vetëm në fund të vitit 2019. Përveç Kodit të Etikës, dy aktet e tjera ende nuk janë bërë publike online, e si pasojë organizatat si organizatore të vullnetarizmit vazhdojnë të mbeten të painformuara mbi formatin dhe përmbajtjen e tyre. Ligji ndërkohë ka mangësitë e tij në zbatim dhe paqartësi, mbi të cilat gjithsesi ka ende nevojë të diskutohet në mënyrë që të jetë i kuptueshëm, mirë interpretuar dhe i zbatueshëm.

Në Tetor 2019 Përtej Barrierave ndërmorri një studim mbi vullnetarizmin në organizatat e shoqërisë civile, ku 58 organizatat nga e gjithë Shqipëria që u bënë pjesë e tij, ngritën dhe një sërë problematikash të tjera të, cilat si pjesë e kësaj iniciative kemi vendosur bashkarisht me organizatat ti adresojmë me institucionet përkatëse dhe të punojmë bashkërisht për ti zgjidhur. Analizën e publikuar me titull “Volunteer infrastructure in Albania - Status quo and developments” mund ta lexoni në këtë [link](#). Studimi i kryer është njëkohësisht pjesë e projektit rajonal ROUTE WB6¹ ku Përtej Barrierave si partner kombëtar për Shqipërinë, sjell dhe këtë diskutim në vend, edhe perspektivën rajonale të zhvillimit të vullnetarizmit dhe modeleve që aplikohen në vendet e Ballkanit Perëndimor, sfidave dhe mësimet të nxjerra në këtë drejtim.

¹ https://www.rycowb.org/?page_id=7813

Në muajt e kaluar kemi zhvilluar disa **takime dhe diskutime** me OSHC dhe rrjete organizatash mbi solidaritetin dhe punën vullnetare, duke u fokusuar në **problematikën që mbart legjislacioni** dhe zbatimin e tij, si dhe duke diskutuar mbi praktika të ndryshme të vullnetarizmit.

Disa nga çështjet kryesore problematike të identifikuara lidhen me:

- njohjen e punës vullnetare,
- kontraktimin e vullnetarëve,
- kostot e sigurimit të vullnetarëve (mbulimin e kostove, por edhe paqartësinë e përlogaritjes së tyre),
- regjistrin e vullnetarëve dhe mënyrën se si do të funksionojë regjistrimi i tyre, etj.

Nisur nga sa më lart dhe interesi ynë për të adresuar këto çështje e kontribuar në krijimin e një mjedisi mundësues për zhvillimin e vullnetarizmit në vend, në vijim do të fillojmë një **dialog me institucionet** me qëllim marrjen e sqarimeve dhe diskutimin për të gjitha çështjet e paqarta. Bazuar në rezultatet e diskutimeve dhe vlerësimin e situatës e zhvillimeve që do të ndodhin për këtë çështje, më tej, do të vijojmë lehtësimin e diskutimit me sektorin për propozime konkrete që t'i hapim rrugë përmirësimit të kuadrit ligjor, çka është në linjë dhe me Prioritetin 5, për përmirësimin e ligjit për Vullnetarizmin në Udhërrefyesin për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019–2023, i rishikuar².

Përveç organizatave dhe rrjeteve të listuara si më poshtë që kanë qenë pjesë e diskutimeve të deritanishme, mbetemi të hapur dhe do të nxisim përfshirjen e të tjera OSHCve të interesuara për të kontribuar në këtë debat.

Për çdo komunikim të mëtejshëm për më shumë informacion mbi këtë çështje dhe/apo për të qenë pjesë e diskutimeve dhe takimeve në vijim, mund të kontaktoni në info@resourcecentre.al dhe office@beyondbarriers.org

Duke Ju falenderuar paraprakisht për vemendjen Tuaj,

Me respekt

(sipas rendit alfabetik)

ACLI – IPSIA, Shqipëri

ALVA - Vlerat Shqiptare

Caritasi Shqiptar

CODE Partners

Forumi i Mendimit të Lirë

Gruaja në Zhvillim

Gruaja te Gruaja

² <https://qbz.gov.al/share/Gz6YWy0kSBOPHiQH8F8cog>

Klubi Ekologjik Elbasan

Klubi Kombëtar i Prindërve me fëmijë CSA dhe PAK

Kongresi Rinor Kombëtar (organizatë ombrellë e rreth 100 subjekteve rinore nga e gjithë Shqipëria me qëllim fuqizimin e rolit të të rinjve në shoqëri)

Korpusi i Paqes, Shqipëri

Korpusi Shqiptar i Vullnetarëve

Lëvizja Europiane në Shqipëri

Nisma për Ndryshim Shoqëror, ARSIS

North Green Association, Shqipëri

Observatori për të drejtat e fëmijëve

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Përtej Barrierave

Projekte Vullnetare Ndërkombëtare (PVN)

Qendra “Jonathan”

Qendra “ACT for SOCIETY”

Qendra “Epoka e Re”

Qendra “The Door”

Qendra “Youth Act”

Qendra e Gruas “Hapa të Lehtë”

Qendra për Mbrojtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri (EcoAlbania)

Qendra Rinore “ARKA”

Qendra Rinore “Sebastia”

Qendra Rinore “Trokitje”

Qendra Sociale në Ndhimë të Njerëzve në Nevojë, Fushë-Arrëz

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin

Rrjeti “Pakti për Zhvillimin e Rinisë”, Shkodër (një rrjet lokal prej 17 organizatash dhe institucionesh që punojnë mbi çështjet e të rinjve)

Rrjeti “Zëri i të Rinjve” (një rrjet kombëtar prej 21 organizatash që punojnë në qarqe të ndryshme në të gjithë vendin, për të rinjtë dhe me të rinjtë)

Rrjeti Kombëtar i Edukatorëve Bashkëmoshatarë -Y-PEER Albania

Shoqata Internacionale Kolping

Shoqata “Ndihmoni Jetën”

Të Rinjtë e Urës Vajgurore

The Power of Education

World Vision, Shqipëri

Zyra për Djem dhe Burra, Shkodër